



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:199650

Datë: 21.01.2025

Numri i dokumentit: 06736369

C.nr.787/2017

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.M. nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sheremet Ademi – avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), në P., me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, më datë 21.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET tërheqja e padisë së paditësit M.M. nga M. e ushtruar kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), në P., me objekt kontesti kompensim dëmi, në këtë çështje juridike kontestimore.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi M.M. nga M., në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), në P., me objekt kontesti kompensim dëmi.

Lidhur me këtë çështje juridike, gjykata më datë ..., ka mbajtur seancën e shqyrtimit përgatitor në këtë çështje juridike.

Me parashtrësën e datës ..., i autorizuari i paditësit e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë e ushtruar në këtë çështje juridike, me arsyetimin se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Me aktvendimin e datës ..., meqënëse e paditura është njoftuar me padinë e ushtruar dhe cilësinë e saj si palë e paditur në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata të njëjtën e ka ftuar që të deklarohet lidhur me tërheqjen e padisë së paditësit, duke e paralajmëruar njëkohësisht edhe për pasojat e mosveprimit konform këtij aktvendimi.

Nga fletëkthesa për dorëzim personal, e cila gjendet në shkresat e lëndës rezulton se e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në P..., aktvendimin e datës ... e ka pranuar më datë ..., e që sipas aktvendimit të lartëcekur afati i fundit për të paditurën për tu deklaruar lidhur me tërheqjen e padisë së paditësit ka qenë data ..., mirëpo meqënëse e njëjta deri në kohën e nxjerrjes së këtij vendimi nuk është deklaruar lidhur me tërheqjen e padisë së paditësit, gjykata konsideron se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë së ushtruar në këtë çështje juridike kontestimore.

Në rastin konkret gjykata gjen se me dispozitën e nenit 261 par.1 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padë”*. Tutje në par.2 të kësaj dispozite përcaktohet se: *“Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.”*, ndërsa në par.3 të saj përcaktohet se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*. Andaj duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së, pasi që nuk ka pasur kërkesë për kompensimin e shpenzimeve të procedurës nga palët ndërgjyqëse.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.787/2017 më datë 21.01.2025

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.